



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet e mbledhjeve: 17-të dhe 18-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/24

Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit "Projekti Emergjent i Kosovës për COVID-19, Financim shtesë", në mes të Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plan i Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës – Agjendës për Reforma Evropiane (PV ERA II).
2. Obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës sipas Planit të Veprimit ERA II që ta zbatojnë atë, sipas afateve të parapara.
3. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit ERA II, për veprimet e parapara për vitin 2021, mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për këtë vit dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij obligohen që të sigurojnë resurset e nevojshme buxhetore për zbatimin e veprimeve të parapara për vitin 2022 dhe 2023.
4. Obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit ERA II që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që ai të ndërlidhet me planet e tyre të brendshme të punës dhe me dokumentet e tjera relevante.
5. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që ta dorëzoj Planin e Veprimit ERA II për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 5,000,000.00 € (pesë milionë euro) për subvencionimin e policave kufitare, në zbatim të vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, masa 4.5 "Mbështetja e Mërgatës", vendimit të Qeverisë Nr. 19/16 të datës 22.06.2021, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit, të datës 24.06.2021.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe transferohen te nën-programi "Thesari" me kod 11200, në kategorinë "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet e ndara sipas këtij vendimi, alokohen në baza mujore deri në lartësinë e faturës së konfirmuar, të cilat shpenzohen dhe transferohen në baza mujore nga Thesari në llogarinë e veçantë bankare të Byrosë Kosovare të Sigurimit të përcaktuar në faturë, në emër të pagesës së primit të sigurimit, në përputhje me kushtet dhe nenin 4. par. 5 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, të datës 24.06.2021.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Thesari për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/24

Datë: 11.08.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet pagesa e shtesave për përfituesit e skemave të ndihmës sociale dhe pensionale të përcaktuara në pikën 3. të këtij vendimi, për periudhën gusht - dhjetor 2021, në zbatim të vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, Masa 3.2 - Mbështetje për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale.
2. Shtesat nga pika 1. e këtij vendimi do të aplikohen si në vijim:
 - 2.1. Pagesë shtesë prej 30% (tridhjetë për qind) mbi shumën mujore për përfituesit nga skema e ndihmës sociale; dhe
 - 2.2. Pagesa shtesë për përfituesit e skemave pensionale që marrin më pak së 100 € (njëqind euro) në muaj, përkatësisht pagesa mujore (pensioni bashkë me shtesën) e përfituesve të arrijë shumën 100€ (njëqind euro) në muaj.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ndahen mjete buxhetore në shumë prej 17,000,000 € (shtatëmbëdhjetë milionë euro) në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe transferohen në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, në nën-programet si vijon:
 - 3.1. Pensionet Bazike-Sociale, me kod 00100, në shumë prej 9,312,500 € (nëntë milionë e treqindëmbëdhjetë mijë e pesëqind euro);
 - 3.2. Pensionet e Aftësisë së Kufizuar, me kod 00200, në shumë prej 3,000,000 € (tre milionë euro);
 - 3.3. Pensioni Invalidor i Punës, me kod 03000, në shumë prej 5,000 € (pesëmijë euro);
 - 3.4. Pensioni Familjar, me kod 02900, në shumë prej 182,500 € (njëqindëtetëdhjetëdy mijë e pesëqind euro);
 - 3.5. Ndihamat Sociale, me kod 00500, në shumë prej 4,500,000 € (katër milionë e pesëqind mijë euro).
4. Mjetet e ndara sipas paragrafit 2. të këtij vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
5. Shtesat sipas këtij vendimi alokohen në kodin e përcaktuar (00098) dhe paguhen në baza mujore, së bashku me pagesën e skemave të rregullta sociale dhe pensionale.

6. Operacionalizimi dhe aktivitetet tjera në zbatim të këtij vendimi realizohen në përputhje me autorizimet e dhëna në pikën 3. të vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021.
7. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 3,000,000.00 € (tre milionë euro) për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore për zbatim të vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, Masa 2.2 "Mbështetja e bizneseve për qasje në financa".
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi, transferohen në vlerë të plotë nga Thesari i Kosovës në llogarinë e përcaktuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, në përputhje me paragrafin 3. të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, si dhe letërkëmbimeve të datës 22.07.2021 dhe 23.07.2021 mbi bazën e Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Thesari për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 5,000,000 € (pesë milion euro) për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207 për zbatimin e vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, Masa 4.3. Mbështetje për kulturë dhe sport. Mjetet ndahen në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, në nën-programet si vijon:
 - 1.1. Sportet e gjera, me kod 80100, në shumë prej 2,000,000 € (dy milionë euro);
 - 1.2. Përkrahja e kulturës, me kod 80500, në shumë prej 2,290,000 € (dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë euro);
 - 1.3. Zhvillimi dhe përkrahja e rinisë, me kod 80700, në shumë prej 500,000 € (pesëqind mijë euro); dhe
 - 1.4. Ruajtja, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, me kod 81500, në shumë prej 210,000 € (dyqindëdhjetë mijë euro).
2. Mjetet e ndara sipas paragrafit 1. të këtij vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Ndarjet buxhetore nga pika 1. e këtij vendimi do të aplikohen për të mbështetur ngjarje të projekteve kulturore, sportive, rinore dhe të trashëgimisë kulturore.
4. Autorizohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për operacionalizimin e masave nga pika 1. e këtij vendimi.
5. Mjetet sipas këtij vendimi alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës, pas plotësimit të kriterëve nga pika 4. e këtij vendimi.
6. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-95 për të Drejtat e Ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Qeveritar për Njohjen e Statusit të Ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë, me mandat dy (2) vjeçar, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fadil Bunjaku, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
 - 1.2. Klit Shala, përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 1.3. Isak Shabani, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.4. Hydajet Hyseni-Kaloshi, përfaqësues nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjegjësisht Komisioni përkatës;
 - 1.5. Berat Luzha, përfaqësues nga Shoqata e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës;
 - 1.6. Mazllum Baraliu, përfaqësues nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.
2. Brenda afatit prej 15 ditësh obligohet Komisioni i lartcekur që ta procedojë në Qeverinë e Republikës së Kosovës një Plan për përmbylljen dhe përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të veta në pajtim me pikën 1. të këtij vendimi.
3. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi që të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-95 për të Drejtat e Ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, me Rregulloren Nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e Ish të burgosurve, të Ish të Dënuarve e të Ish të Përndjekurve Politikë si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të bashkëpunimit ndërinstitucional për mbrojtjen dhe fuqizimin e rinisë dhe adresimin e sfidave të vazhdueshme me të cilat ajo ballafaqohet në të gjithë sektorët e qeverisjes qendrore përmes hartimit të politikave horizontale, emërohet Komisioni Shtetëror për Rini.
2. Komisioni Shtetëror për Rini është mekanizëm koordinues ndërinstitucional dhe është përgjegjës për koordinimin dhe zhvillimin e dokumenteve strategjike. Përgjegjësitë e KShR-së janë për:
 - 2.1. Sigurimin e harmonizimit të dokumenteve strategjike si programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe planet e punës të ministrive, strategjitë nacionale që ndërlidhen me rininë;
 - 2.2. Filtrimin dhe përcaktimin përfundimtar të prioritetëve parësore të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe shqyrtimin e nismave të politikave të reja në fushën e rinisë;
 - 2.3. Prioritizimin e masave dhe programeve sektoriale për qëllim të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitorimin dhe vlerësimin periodik të zbatimit të saj;
 - 2.4. Shqyrtimin dhe vendimmarrjen e çështjeve të rëndësishme për rininë e Republikës së Kosovës.
3. Komisioni Shtetëror si në pikën një 1. të këtij vendimi ka këtë përbërje:
 - 3.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 3.2. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 3.3. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
 - 3.4. Ministria e Shëndetësisë;
 - 3.5. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
 - 3.6. Ministria e Ekonomisë;
 - 3.7. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
 - 3.8. Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.
4. Ministrat e institucioneve që përbëjnë Komisionin Shtetëror, emëruar me këtë vendim, kanë për detyrë identifikimin e zëvendësministrit përgjegjës për fushën e Rinisë dhe emërimin e tij si anëtar në këtë mekanizëm.
5. Komisioni Shtetëror kryesohet nga Zëvendësministri për Rini i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

6. Komisioni Shtetëror, i emëruar me këtë vendim, ka për detyrë të takohet më së paku dy herë në vit dhe që të identifikojë të gjithë akterët të cilët do të kontribuojnë në fushën e Rinisë dhe njëkohësisht të kërkojë nga ata veprime konkrete në fuqizimin e rinisë në vendin tonë.
7. Komisioni Shtetëror do të emëroj një grup këshillëdhënës në përbërje të institucioneve dhe mekanizmave përkatës të cilët do të japin këshilla dhe rekomandime konkrete në fushën e rinisë dhe njëkohësisht do të marrin pjesë në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rini, si dhe në zbatimin e objektivave strategjike të cilat do të dalin nga Strategjia Kombëtare për Rini. Ky grup do të takohet më së paku katër herë në vit dhe për punën e tyre do t'i raportojë Komisionit Shtetëror për Rini.
8. Komisioni Shtetëror ka të drejtë që të propozoj zgjerimin e përbërjes së tij, duke shtuar edhe ministri apo institucione tjera të cilat do të mund të kontribuonin në komision.
9. Obligohen të gjitha ministratë dhe institucionet tjera që janë pjesë e administratës shtetërore nën autoritetin e Qeverisë që të ofrojnë bashkëpunim dhe ndihmë në të gjitha rastet kur kjo kërkohet nga ana e Komisionit Shtetëror i emëruar me këtë vendim.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/24

Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i lejohet që mjetet në vlerë prej 247,000 €, (dyqind e katërdhjetë e shtatë mijë euro) të ndara nga Fondi i Ringjalljes Ekonomike, kategoria e subvencioneve, t'i shpenzojë për blerjen e veprave të artit nga artistët vendorë.
2. Veprat që lejohet të blihen janë vepra vizuale dhe audivizuale.
3. Për blerjen e veprave artistike si në pikën 1. të këtij vendimi, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit obligohet të hapë thirrje publike për blerjen e veprave.
4. Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e veprave artistike për blerje, MKRS obligohet të emërojë një juri profesionale.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Statusin e Forcave (SOFA) ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Polonisë.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Mbrojtjes obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Vlerësimit të Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve të Komunave për muajt Janar - Qershor 2021.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin Raportit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/24
Datë: 11.08.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenin 64 të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, të nenit 11 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 17/38 i datës 30.10.2020, si në vijim:
 - 1.1. Dr. Naim Hoxha, Spitali i Përgjithshëm i Ferizajt zëvendësohet me Dr. Hanumshahe Kingji, Spitali i Përgjithshëm i Pejës;
 - 1.3. Dr. Diellor Rizaj – Ministria e Shëndetësisë zëvendësohet me Mentor Bislimi, Ministria e Shëndetësisë.
2. Pjesa tjetër e Vendimeve mbetet e pandryshuar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/24
Datë: 11.08.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 gusht 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 08 - P - 024 të datës 13.07.2021, jep mendim lidhur me nismën legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, duke mbështetur:
 - 1.1. Nismën legislative nga pika 1. e këtij Vendimi, e cila ka përcaktuar që 24 Qershori, dita e egjiptianëve të shënohet si ditë memoriale në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. Kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme që si ditë memoriale të shënohet edhe data 26 Korrik, "dita e policëve të rënë në kryerje të detyrës", dhe e njëjta të konsiderohet gjatë procesit të plotësim/ndryshimit të Ligjit për Festat Zyrtare;
 - 1.3. Në harmoni me atë që u tha më lartë, Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, vlerëson së "Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk do të krijojë kosto shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi që me këtë Projektligj përfshihet vetëm data 24 Qershor si dita e egjiptianëve dhe si e tillë shënohet si ditë memoriale";
 - 1.4. Po ashtu, Divizioni për të Drejtën e BE-së në Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, në Opinionin e Përputhshmërisë me Acquis të BE-së vlerëson së "dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës nuk janë të rregulluara me legjislacionin e BE-së dhe si e tillë kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencë të brendshme të shteteve anëtare të BE-së".
2. Ky vendim së bashku me mendimet e ministrive përkatëse i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë